

**VENDIM**  
**Nr. 6, datë 11.1.2017**

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE PUBLIKE**  
**PËR VITIN 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2017, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Integritimit Evropian, Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2017.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**Lidhja nr.1**

**KALENDARI PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2017**

| PERIUDHA       | DATA                 | INSTITUCIONI<br>PËRGJEGJËS           | VEPRIMI PERKATES                                                                                                                                                    |
|----------------|----------------------|--------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Janar          | 6                    | MF                                   | Përgatit dhe paraqet në KM Kalendarin e MSHP.                                                                                                                       |
| Janar          | 11                   | KM                                   | Shqyrton dhe miraton Kalendarin e MSHP.                                                                                                                             |
| Janar          | 18                   | MF                                   | Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2018 - 2020.                                                                                                           |
| Janar          | 27                   | KM                                   | Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2018 - 2020.                                                                                                                 |
| Shkurt         | 17                   | MF                                   | Paraqet në KM tavanet e përgatitjes së PBA 2018-2020 dhe limitet e angazhimeve të reja.                                                                             |
| Shkurt         | 22                   | KM                                   | Shqyrton dhe miraton tavanet e përgatitjes së PBA 2018-2020.                                                                                                        |
| Shkurt         | 28                   | MF                                   | Dërgon udhëzimin e Përgatitjes së Buxhetit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe udhëzimin për përgatitjen e buxhetit vendor në njësitë e qeverisjes vendore. |
| Mars           | 10                   | KM                                   | Paraqet për informacion në Kuvend Kuadrin Makroekonomik e Fiskal , si dhe Tavanet e përgatitjes së PBA 2018-2020.                                                   |
| Mars - prill   | 1 Mars - 28 Prill    | Njësite e Qeverisjes së Përgjithshme | Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore.                                                                                                                               |
| Maj            | 1                    | Njësite e Qeverisjes së Përgjithshme | Paraqesin në MF kërkesat e tyre buxhetore.                                                                                                                          |
| Maj            | 2 - 19               | MF, MIE dhe DPZHFNH                  | Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore.                                                                                                                             |
| Maj - qershor  | 22 Maj - 2 Qershor   | MF, MIE dhe DPZHFNH                  | Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme.                                                                                                |
| Qershor        | 5                    | MF                                   | Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (në rast se shihet e nevojshme).                                                                          |
| Qershor        | 7                    | KM                                   | Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (në rast se shihet e nevojshme).                                                                                |
| Qershor        | 12-22                | MF                                   | Përgatit dokumentin e PBA 2018-2020, tavanet e reja të shpenzimeve të PBA 2018-2020 dhe limitet e angazhimeve të reja.                                              |
| Qershor        | 23                   | MF                                   | Paraqet dokumentin e PBA 2018-2020, tavanet e reja të shpenzimeve dhe limitet e angazhimeve të reja, për shqyrtim dhe miratim në KM.                                |
| Qershor        | 28                   | KM                                   | Miraton dokumentin e PBA 2018-2020 dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA 2018-2020.                                                                              |
| Korrik         | 3                    | MF                                   | I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA 2018-2020.                                                                                                      |
| Korrik         | 7                    | MF                                   | Dërgon udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.                                                                      |
| Korrik - gusht | 10 Korrik - 31 Gusht | Njësite e Qeverisjes së Përgjithshme | Përgatisin kërkesat e rishikuara buxhetore.                                                                                                                         |
| Shtator        | 1                    | Njësite e Qeverisjes së Përgjithshme | Paraqesin në MF kërkesat e rishikuara buxhetore.                                                                                                                    |
| Shtator        | 2-15                 | MF, MIE dhe DPZHFNH                  | Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore.                                                                                                               |
| Shtator        | 16 - 29              | MF, MIE dhe DPZHFNH                  | Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme.                                                                                                |
| Shtator        | 29                   | MF                                   | Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (në rast se shihet e nevojshme).                                                                          |
| Tetor          | 4                    | KM                                   | Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (në rast se shihet e nevojshme).                                                                                |
| Tetor          | 5-12                 | MF                                   | Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2018, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA                                                                                         |

|       |    |    |                                                                                                             |
|-------|----|----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|       |    |    | 2018-2020 dhe i paraqet për shqyrtim në KM.                                                                 |
| Tetor | 15 | KM | Miraton Projektbuxhetin e vitit 2018, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2018-2020.                       |
| Tetor | 19 | MF | Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA 2018-2020, të miratuar nga KM. |
| Tetor | 20 | KM | I paraqet Kuvendit Projektbuxhetin e vitit 2018.                                                            |

